



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
Këshilli i Gjykatës

Nr. 26 Prot.

Tiranë, më 01/04/2021

V E N D I M

Nr. 46, datë 01/04/2021

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË GJYKATËS SË LARTË NR. 1, DATË 21.01.2021 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS, PËRSHKRIMIN E PUNËS DHE KLASIFIKIMIT TË VENDEVE TË PUNËS TË PUNONJËSVE TË GJYKATËS SË LARTË"

Në mbështetje të shkronjës "c" të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 643, datë 23.12.2020 "Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë"; të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 11.03.2021 "Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2021", Këshilli i Gjykatës së Lartë, në mbledhjen e datës 01.04.2021,

V E N D O S I :

1. Në organikën e Gjykatës së Lartë sipas Lidhjes nr. 1 të Vendimit nr. 1, datë 21.01.2021 "Për miratimin e strukturës, organikës, përshkrimin e punës dhe klasifikimit të vendeve të punës të punonjësve të Gjykatës së Lartë", bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) në organikën e Drejtorisë së Administrimit Gjyqësor shtohen 3 (tre) nëpunës civilë gjyqësorë (sekretare gjyqësore), nga të cilët:
 - 2 (dy) sekretare në Sekretarinë e regjistrimit të çështjeve; dhe
 - 1 (një) sekretare në Sekretarinë Gjyqësore;
 - b) në organikën e Qendrës së Dokumentacionit shtohen 3 (tre) nëpunës civilë gjyqësorë, nga të cilët:
 - 2 (dy) nëpunës në Sektorin e Publikimit dhe të Statistikave; dhe
 - 1 (një) nëpunës në Sektorin e Kërkimit Ligjor dhe Bibliotekës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
ILIR PANDA



ANËTAR
KELMENT GRECA